



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Neneve 15.2 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
3. Kërkesën e N.Q Termokos për derogim në zbatimin e disa dispozitave të Licencave të “N.Q Termokos”, të datës 13.08.2008, **në seancën e mbajtur më 15 gusht 2008 nxori këtë:**

VENDIM

I. I lejohet “N.Q Termokos” derogimi në zbatimin e dispozitave të neneve të:

- Licencës për Gjenerim të Ngrohjes Qendrore;
- Licencës për Shpërndarjen e Ngrohjes Qendrore; dhe
- Licencës për Furnizim Publik me Ngrohje Qendrore, si në shtojcën e këtij vendimi.

1. Të gjitha dispozitat tjera të licencave të “N.Q Termokos” mbesin në fuqi.
2. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
3. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e lejimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
4. Ky Vendim hyn në fuqi me datën e lëshimit të tij ose datën e publikimit të këtij vendimi në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Nysret Avdiu, anëtar



Nenet e deroguara të Licencave të N.Q Termokos

Licenca e Gjenerimit N.Q Termokos			
Nr.	Neni	Kërkesa për derogim	Koment nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Bizneset gjeneruese	deri me 31 dhjetor 2008	Sipas nenit 2.1 NQ Termokos duhet të dorëzoi në ZRRE Raportin Financiar të Audituar për vitin 2007, të cilin ende nuk e ka dorëzuar. Për Llogarite e Ndara, Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2008.
2.	Neni 5-Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes , Kodin Matës dhe RRPFE	deri me 31 dhjetor 2008	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afatit gjer me 31.12.2008.
3	Neni 7-Shëndeti dhe Siguria	deri me 15 shtator 2008	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afatit gjer me 15.09.2008.
4	Neni 8-Mjedisi	deri me 31 dhjetor 2008	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afatit gjer me 31.12.2008.
5	Neni 11-Obligimi i Sigurimit	deri me 30 prill 2009	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afatit gjer me 30.04.2009.
Licenca për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes			
Nr.	Neni	Kërkesa për derogim	Koment nga ZRRE
1	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Biznesin e Shpërndarjes	deri me 31 dhjetor 2008	Sipas nenit 2.1 NQ Termokos duhet të dorëzoi në ZRRE Raportin Financiar të Audituar për vitin 2007, të cilin ende nuk e ka dorëzuar. Për Llogarite e Ndara, Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2008.
2	Neni 4-Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit, Kodin Matës dhe RRPFE	deri me 31 dhjetor 2008	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afatit gjer me 31.12.2008.
3	Neni 6.8 Deklarata (çmimore) mbi tarifrat për kyçe në sistemin e shpërndarjes	deri me 30 shtator 2008	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afatit gjer me 31.12.2008.
4	Neni 7.1-Qasja dhe Shfrytëzimi i Rrjetit të Shpërndarjes së Ngrohjes	deri me 31 dhjetor 2008	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afatit gjer me 31.12.2008.
5	Neni 9.1 Blerja Ekonomike e Aseteve dhe Shërbimeve	deri me 30 prill 2009	Bordi i ZRRE-se ka aprovuar shtyrje afatit gjer me 30.04.2009.
6	Neni 12.1-Standardet e Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe Planifikimit	deri me 31 dhjetor 2008	Bordi i ZRRE-se ka aprovuar shtyrje afatit gjer me 31.12.2008.
7	Neni 13.2-Standardet e Përbushjes së Biznesit të Sistemit të Shpërndarjes	deri me 31 dhjetor 2008	Bordi i ZRRE-se ka aprovuar shtyrje afatit gjer me 31.12.2008.
8	Neni 14-Qasja në Tokë dhe Ndërtesë	deri me 30 shtator 2008	Bordi i ZRRE-se ka aprovuar shtyrje afatit gjer me 30.09.2008.
Licenca për Furnizim Publik me Ngrohje Qendrore			
Nr.	Neni	Kërkesa për derogim	Koment nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Biznesin e Furnizimit	deri me 31 dhjetor 2008	Sipas nenit 2.1 NQ Termokos duhet të dorëzoi në ZRRE Raportin Financiar të Audituar për vitin 2007, të cilin ende nuk e ka dorëzuar. Për Llogarite e Ndara, Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afati deri me 31.12.2008.
2	Neni 4-Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit, Kodin Matës dhe RRPFE	deri me 31 dhjetor 2008	Bordi i ZRRE-së ka aprovuar shtyrje afatit gjer me 31.12.2008.